

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE, PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar kontributin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve nën mbikëqyrje;

Duke njohur misionin e Autoritetit për krijimin e një tregu bashkëkohor dhe efektiv, që ofron shërbime cilësore dhe promovon zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar jobankar në vend;

Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë Autoritet, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare,

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit 2020, në drejtim të:

- Masave të marra për minimizimin e efekteve negative të pandemisë COVID-19 në tregjet e mbikëqyrura, nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të treguesve të likuiditetit të shoqërive të sigurimit duke kërkuar pezullimin e shpërndarjes së dividendit dhe zbatimin e një qasje të kujdesshme për shpërblimet e stafit, përditësimin e planeve të vazhdimësisë së veprimtarisë dhe planeve për përballimin e krizës, rritjen e frekuencës së raportimit të flukseve të shlyerjeve neto nga dyjavore në ditore për shoqëritë administruese të fondeve, etj.;

- Mbiqëqyrjes përgjatë vitit 2020 të procesit të pagesave të dëmshpërblimit si pasojë e ngjarjeve të tërmetit të vitit 2019, si dhe bashkëpunimin me shoqëritë e sigurimit, me qëllim nxitjen dhe ndërmarrjen e iniciativave në funksion të zgjerimit të mbulimit të sigurimit të pronës;

- Përmirësimit të aspekteve të funksionimit dhe rregullimit të tregjeve të kapitalit dhe të fondeve të investimeve dhe fondeve të pensionit vullnetar, nëpërmjet plotësimit dhe përafrimit të kuadrit ligjor dhe rregullator;

- Angazhimit dhe kontributit të dhënë për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të adresuara në raportin e MONEYVAL-it jo vetëm nëpërmjet plotësimit të kuadrit rregullator ose nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, por edhe nëpërmjet realizimit të 20 inspektimeve të dedikuara për verifikimin e zbatimit të dispozitave ligjore për sa u përket sanksioneve ndërkombëtare në këtë fushë;

- Marrjes së 20 vendimeve për vendosjen e masave administrative dhe korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura në tregun e sigurimeve dhe tregun e titujve, përfshirë edhe revokimin e licencës për një shoqëri brokerimi dhe 6 vlerësues të pavarur në sigurime, si dhe broker e këshilltar investimesh në tregun e titujve;

- Verifikimit periodik nëpërmjet inspektimeve në shoqëritë e sigurimit dhe Byronë Shqiptare të Sigurimit për saktësinë e të dhënave të raportuara dhe monitorimin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, për dëmet objekt i Fondit të Kompensimit;

- Monitorimit të veprimtarisë promociionale dhe transparencës së subjekteve të mbikëqyrura, në funksion të mbrojtjes së konsumatorit dhe investitorit, si dhe angazhimit nga ana e tij për hartimin e disa dokumenteve shumë të rëndësishme në këtë drejtim, siç janë: “Strategjia për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje” dhe “Karta e të drejtave të konsumatorit dhe investitorit në tregjet nën mbikëqyrje”;

- Shqyrtimit dhe trajtimit nëpërmjet regjistrit *online* të një numri total prej 183 ankesash të konsumatorëve dhe investitorëve, nga të cilat vetëm 2 ankesa lidhen me fondet vullnetare të pensionit dhe fondet e investimeve, ndërsa 181 ankesat e tjera i përkasin tregut të sigurimeve dhe më së shumti sigurimit të detyrueshëm motorik dhe sigurimit nga tërmeti;

- Digjitalizimit dhe modernizimit të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit nëpërmjet përmirësimit të mëtejshëm të dy sistemeve të raportimit të shoqërive të tregjeve nën mbikëqyrje, përshtatjes së plotë të Regjistrit Elektronik *Online* të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm

Motorik me sistemet e reja të institucioneve, me të cilat bashkëvepron sistemi i AMF-së dhe përfundimit të analizës teknike dhe ndjekjes në vijim të procesit për ofrimin e disa shërbimeve të tregjeve të mbikëqyrura nëpërmjet platformës *e-Albania*;

- Bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizata ndërkombëtare, si: IOSCO dhe IOPS nëpërmjet përshtatjes së rekomandimeve dhe planeve të veprimit të propozuara nga këto organizata për përballimin e situatës emergjente të shkaktuar nga pandemia.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për vitin 2021, të angazhohet në këto drejtime:

- Të plotësojë, brenda vitit 2021, të gjithë kuadrin nënligjor nën zbatim të ligjeve të miratuara nga Kuvendi për tregjet e kapitalit, fondet e investimit dhe sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, të cilat do të shërbejnë jo vetëm për modernizimin e tregjeve me praktikën e vendeve evropiane, por edhe për krijimin e mundësive të reja për zhvillimin e tyre;

- Të nxisë pjesëmarrjen në skemat profesionale të pensionit dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregut të fondeve të pensioneve vullnetare nëpërmjet përafrimit të ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009, “Për fondet e pensionit vullnetar” me direktivat e BE-së në këtë fushë, me qëllim krijimin e formave të ndryshme të fondeve të pensionit, që do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në ndërgjegjësimin e kompanive dhe industrive vendase si një politikë për motivimin e punonjësve të tyre;

- Të përmirësojë praktikën mbikëqyrëse, si dhe të avancojë më tej drejt mbikëqyrjes së plotë me bazë riskun, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë dhe modernizimit të sistemeve të raportimit në funksion të rritjes së eficiencës në proceset mbikëqyrëse;

- Të fokusohet në monitorimin e vazhdueshëm të treguesve financiarë të subjekteve të mbikëqyrura, si dhe të nxisë zhvillimet e reja në drejtim të krijimit të produkteve dhe shërbimeve inovative nëpërmjet digjitalizimit;

- Të përfundojë, brenda vitit 2021, procesin për ofrimin e shërbimeve të verifikimit të policës së sigurimit motorik, vërtetimit të historikut të mjetit dhe vërtetimit të historikut të dëmit nëpërmjet platformës *e-Albania*;

- Në funksion të transparencës, të vazhdojë publikimin e vendimeve të Bordit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, të paraqesë në Kuvend së bashku me raportin vjetor informacion të hollësishëm për vendimet e ankimuara të Bordit dhe rezultatit e inspektimeve të subjekteve të mbikëqyrura;

- Të ketë në fokus zhvillimin profesional dhe motivimin e punonjësve për arritjen e objektivave të institucionit, duke i përfshirë jo vetëm në trajnime të profilizuara sipas dinamikës së tregjeve nën mbikëqyrje, por edhe në trajnime për rritjen e kapaciteteve për sa i takon forcimit të luftës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

- Të monitorojë në vijimësi ndërmjetësit që operojnë në tregjet nën mbikëqyrje, si dhe të angazhohet në nisma dhe aktivitete edukuese e promovuese, me qëllim mbrojtjen e personave të siguar dhe investitorëve.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 27.5.2021.